



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT**

V E N D I M

Nr. 01, datë 25.08.2025

**PËR
PÛRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË EVIDENTIMIT NË TERREN TË
PASURIVE ME ZË KADASTRAL "PEMËTORE" APO "ULLISHTE", GJATË
SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT PËR LEJE ZHVILLIMI / NDËRTIMI NË
KOMPETENCË TË KKTU-SË**

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 37 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; neneve 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 7929, datë 11.05.1995 "Për mbrojtjen e drufrutorëve", Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit" i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Për të gjitha vendimmarrjet e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, në rast se projekt – propozimet shtrihen mbi pasuri me zë kadastral "pemëtore" apo "ullishte", në të cilat nga evidentimi në terren rezulton të mos ketë pemëtore, drufrutorë ose ullinj, subjekti duhet të depozitojë pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit si Sekretariat Teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Proçesverbal i gjendjes faktike të sipërfaqes së tokës ullishte apo me kultura drufrutore në terren, të shoqëruar me foto të gjendjes ekzistuese, i mbajtur nga topografi, i cili deklaron se pasuria e cila është verifikuar, është e njëjta sipas dokumentit të pronësisë, dhe agronomi, i cili verifikon gjendjen faktike mbi ekzistencën ose jo të kulturave drufrutore apo ullinjve. Proçesverbali, nënshkruhet gjithashtu nga pronari i pasurisë apo përfaqësuesi i zhvilluesit të projekt propozimit.
 - b) Deklaratë noteriale e përbashkët midis zhvilluesit dhe eksperit që ka hartuar proçesverbalin e gjendjes faktike, të cilët deklarojnë nën përgjegjësinë e tyre të plotë civile dhe penale për vërtetësinë e dokumentacionit të depozituar.

LI I MINISTRAVE

2. Pas depozitimit të dokumentacionit, sipas pikës 1 të këtij vendimi:

- 2.1. Për sipërfaqet deri në 0.1 ha, konfirmimi i gjendjes faktike të pasurive, për të cilat është deklaruar që nuk ka pemtore/ drufrutorë, kryhet nga specialisti agronom përkatës pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore brenda 5 ditëve pune. Në rast se njësia e vetëqeverisjes vendore nuk përgjigjet brenda afatit 5 ditor, konfirmimi kryhet nga specialisti agronom pranë Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor përkatëse.
 - 2.2. Për sipërfaqet mbi 0.1 ha, konfirmimi i gjendjes faktike të pasurive, për të cilat është deklaruar që nuk ka pemtore/ drufrutorë, kryhet nga specialisti agronom përkatës pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe nga specialisti agronom pranë Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor përkatëse, brenda 5 ditëve pune. Në rast se njësia e vetëqeverisjes vendore nuk përgjigjet brenda afatit 5 ditor, konfirmimi kryhet nga specialisti agronom pranë Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor përkatëse brenda 5 ditëve.
 - 2.3. Për sipërfaqet deri 0.1 ha, konfirmimi i gjendjes faktike të pasurive, për të cilat është deklaruar që nuk ka ullinj, kryhet nga specialisti agronom përkatës pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe nga specialisti agronom pranë Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor përkatëse, brenda 5 ditëve pune. Në rast se njësia e vetëqeverisjes vendore nuk përgjigjet brenda afatit 5 ditor, konfirmimi kryhet nga specialisti agronom pranë Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor përkatëse brenda 5 ditëve.
 - 2.4. Për sipërfaqet mbi 0.1 ha, konfirmimi i gjendjes faktike të pasurive, për të cilat është deklaruar që nuk ka ullinj, kryhet nga specialisti agronom pranë Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor përkatëse dhe specialisti përkatës i MBZHR, brenda 5 ditëve pune.
3. Pas konfirmimit të kryer nga njësia e vetëqeverisjes vendore apo Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor përkatëse, sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij vendimi, Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit mund të vijojë me procedurat përkatëse për lëshimin e dokumentit të lejes së zhvillimit apo ndërtimit.
 4. Një kopje e konfirmimit të kryer nga njësia e vetëqeverisjes vendore apo Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor përkatëse, sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij vendimi, depozitohet edhe pranë Drejtorisë përkatëse Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.
 5. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor për zbatimin e këtij vendimi.
 6. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës, anëtarët dhe sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTRAT

BELINDA BALLUKU
ANËTAR I KKTU

ULSI MANJA
ANËTAR I KKTU

MIRELA KUMBARO FURXHI
ANËTAR I KKTU

BLENDI GONXHJA
ANËTAR I KKTU

DELINA IBRAHIMI
ANËTAR I KKTU

PIRRO VENGU
ANËTAR I KKTU

ALBANA KOÇIU
ANËTAR I KKTU

PETRIT MALAJ
ANËTAR I KKTU

REPUBLICA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
TIRANË

REPUBLICA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E DREJTËSISE
TIRANË

REPUBLICA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MËDIT
TIRANË

REPUBLICA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E INNOVACIONIT
DHE TEKNOLOGJISË
TIRANË

REPUBLICA E SHQIPËRISE
KRYEMINISTRIA
TIRANË

REPUBLICA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJESË
DHE Mbrojtjes
TIRANË

REPUBLICA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E SHËNDESES DHE
Mbrojtjes
TIRANË

REPUBLICA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCARË
DHE TREGTISË
TIRANË

Nënshkruar më datë 29.08 / 2025

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANILA DENAJ



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJBAROKA

